

Vendim nr.271 datë 22.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 22 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATMIR CENAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-119, datë 28.01.2025 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 78

dhe 278 paragrafët 1 dhe 2, të Kodit Penal (KP). Nga rrethanat ka rezultuar se kërkuesi ka qëlluar me armë automatike shtetasin J.B. (fqinj i tij) dhe më pas është arrestuar në flagrancë nga oficerët e Policisë Gjyqësore. Kërkuesi ka pranuar se ka kryer vrasjen për shkak të konflikteve të vazhdueshme që ka pasur me viktimën.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 322, datë 19.11.2018, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit dhe në aplikim të gjykimit të shkurtuar e ka dënua atë me 16 vjet e 8 muaj burgim, me arsyetimin se i ka konsumuar plotësisht elementet e veprave penale për të cilat akuzohet. Sipas gjykatës, kërkuesi e ka pritur viktimën në vendin ku ky i fundit kalonte për të kryer punët e tij, ka pritur momentin kur viktima është afruar dhe pas një debati verbal ka qëlluar në drejtim të viktimës. Ajo gjykatë nuk ka pranuar pretendimet e mbrojtjes së kërkuesit për cilësimin juridik të veprës penale në vrasje të kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit të parashikuar nga neni 82 i KP-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 157, datë 09.04.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.322, datë 19.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me arsyetimin se ai vendim është marrë në analizë të drejtë dhe të plotë të provave e të ligjit, duke arsyetuar në mënyrë të detajuar si fajësinë e kërkuesit, ashtu edhe masën e dënimit të caktuar ndaj tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-119, datë 18.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 22.04.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykatat e zakonshme kanë bërë një cilësim të gabuar të ngjarjes penale, duke e akuzuar dhe dënua padrejtësisht atë për vrasje me paramendim në kundërshtim me rrethanat, provat e dokumentuara dhe deklarinimet e dëshmitarëve të pyetur. Edhe Gjykata e Lartë ka marrë një vendim të padrejtë dhe të paargumentuar, duke mos pranuar rekursin e kërkuesit dhe ndonëse ka pranuar se nuk është gjykatë fakti, u është referuar fakteve të padrejta. Kjo gjykatë nuk ka marrë parasysh shkeljet e rënda të kryera nga gjykatat më të ulëta. Këto të fundit kanë arsyetuar në mënyrë të gabuar se kërkuesi ka përgatitur kryerjen e

krimit, ka siguruar mjetin për këtë qëllim dhe se viktimë ka pasur probabilitet për të kaluar si zakonisht në pronën e dikujt tjetër, ngjitur me atë të kërkuesit. Në të vërtetë ka qenë viktimë që ka ardhur në pronën e kërkuesit me qëllim për t'u konfliktuar, duke e sulmuar verbalisht dhe fizikisht me një shkop që e kishte me vete. Edhe nga kampioni i gjakut i gjetur në shkop provohet se viktimë ka pasur qëllim për të vrarë kërkuesin, por kjo provë është fshehur dhe nuk është marrë parasysh, me arsyetimin se është ruajtur në kushte jo të mira teknike. Vepra penale është kryer në tokën e kërkuesit, atij i është gjendur arma e krimit dhe konflikti ka qenë i çastit. Dëshmia e shtetasit G.B., vëllai i viktimës, është marrë jo e plotë me qëllim për të tjetërsuar të vërtetën e ngjarjes dhe kërkuesi nuk është ballafaquar asnjëherë me këtë dëshmitar. Gjithashtu, nuk është marrë parasysh dëshmia e shtetasës D.M. që vërteton se viktimë është konfliktuar me kërkuesin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave

të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ndaj ai e ka plotësuar edhe këtë kriter.

10. Po kështu, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 28.01.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur fillimisht në datën 22.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se ndonëse në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, në përmbajtjen e tij ka parashtruar pretendime edhe për procesin e zhvilluar në gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim ai ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë bërë një cilësim të gabuar të ngjarjes penale, duke e akuzuar dhe dënuar padrejtësisht për vrasje me paramendim në kundërshtim me rrethanat, provat e dokumentuara dhe deklaratimet e dëshmitarëve të pyetur. Sipas tij, edhe Gjykata e Lartë ka marrë një vendim të padrejtë dhe të paargumentuar, duke mos pranuar rekursin e kërkuesit dhe, ndonëse ka pranuar se nuk është gjykatë fakti, u është referuar fakteve të padrejta. Ai ka pretenduar gjithashtu se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh shkeljet e rënda të kryera nga gjykatat më të ulëta.

12. Nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit që lidhet me mënyrën e interpretimit të legjislacionit penal për sa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale, për të cilën ai është dënuar, Kolegji çmon t’i analizojë ato në drejtim të *gjyimit të drejtë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjyimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, po ashtu, ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po kështu, Gjykata, në jurisprudencën e saj ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 2 datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se kërkuesi është proceduar me ritin e gjyqimit të shkurtuar dhe është deklaruar fajtor për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”. Ai e ka pranuar faktin penal, por ka pretenduar se vrasja e viktimës nuk është kryer me dashje, por ka ndodhur në kushtet e tronditjes së fortë psikike. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë arsyetuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi kërkuesi dispononte një armë të llojit automatik, ditën e ngjarjes ai kishte marrë masa që këtë armë ta vendoste në një thes dhe më pas atë ta vendoste në vendin arë ku ai rrinte zakonisht dhe ku kalonte viktimja gjatë punëve të tij të përditshme, çka tregon parapërgatitje të vendit ku do të ndodhej arma; ai e ka pritur viktimën derisa ka ardhur dhe pas një konflikti verbal, ka qëlluar mbi të dy herë. Sipas këtyre gjykatave, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, kërkuesi e ka përzgjedhur kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, pasi në të kundërt veprimet e tij do të ishin instiktive dhe ai do të vepronte në momentin e parë që ka parë viktimën, pa u kujdesur për vendin ose kohën. Po kështu, ndonëse kërkuesi ka pasur konflikte të mëparshme me viktimën, ai ka treguar vetëpërmbajtje dhe aftësi për të kontrolluar tronditjen psikike që mund të jetë shkaktuar nga debati ndërmjet tyre, duke pritur një javë për të kryer veprën penale të vrasjes. Po kështu, gjykata e apelit ka pohuar se vetë kërkuesi nuk ka deklaruar se ka pasur përleshje me viktimën, e provuar kjo edhe nga thëniet e dëshmitarit dhe se nga përgjimet ambientale rezultojnë se ai e ka pranuar se e ka kryer veprën, duke marrë në konsideratë konfliktin shumëvjeçar me viktimën. Kjo gjykatë ka vlerësuar gjithashtu se ngjyra e kuqe dhe ajo jeshile në pantallonat e kërkuesit janë rezultat i rrethanave të rastësishme, që nuk kanë asnjë lidhje me mekanizmin e kryerjes së veprës penale, pasi edhe vetë ai nuk ka kërkuar të kryhet ndonjë akt ekspertimi mjeko-ligjor për dëmtime në trupin e tij.

16. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Fillimisht ky kolegji ka vlerësuar se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, ai ka arsyetuar se gjykata e apelit ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë si dhe duke vënë në dukje se gjykimi i kësaj çështjeje penale është zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, në gjendjen e akteve të fashikullit të gjykimit. Sipas këtij kolegji, gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje pretendimeve të argumentuara dhe ka trajtuar pretendimet e tij të parashtruara në rekurs dhe fakti që konkluzionet e gjykatës së apelit nuk përputhen me pretendimet e kërkuesit për kualifikimin e faktit penal, nuk do të thotë se vendimi i rekursuar është i paarsyetuar. Në këtë drejtim, Kolegji Penal ka arritur në përfundimin se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuesit për analizimin e anës objektive të veprës penale.

17. Në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Kolegji konstaton se gjykatat e faktit kanë analizuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ka qenë i akuzuar kërkuesi, si në aspektin objektiv, ashtu edhe në atë subjektiv, duke i dhënë përgjigje shteruese faktit se vrasja e viktimës është kryer me paramendim dhe jo në kushtet e tronditjes së fortë psikike. Gjithashtu, ato gjykata për të arritur në konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale janë bazuar në një sërë provash të administruara në gjykim dhe të vlerësuara prej tyre në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën, të tilla si deklaratimet e kërkuesit në momentin fillestar të arrestimit të tij, deklaratimet e dëshmitarëve (përfshi edhe atë të pranishëm në vendin e ngjarjes), njollat e gjakut në pantallonat e kërkuesit, përgjimi ambiental mes tij dhe bashkëshortes. Për sa i përket pretendimeve të kërkuesit se nuk është analizuar njolla e gjakut e gjetur në shkop, Kolegji vëren se gjykatat përveç se kanë evidentuar faktin se ajo është marrë dhe ruajtur në kushte jo të mira teknike, në kualifikimin e veprës penale dhe të dinamikës së ngjarjes janë bazuar edhe në deklaratimet e kërkuesit se mes tij dhe viktimës nuk ka pasur përleshje, si dhe në faktin se vetë kërkuesi nuk ka kërkuar të kryhet ndonjë akti ekspertimi mjeko-ligjor për dëmtime në trupin e tij. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, ndërkohë që interpretimi i ligjit prej tyre, i shprehur përmes arsyetimit të vendimit, nuk duket të jetë i paarsyeshëm ose eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës.

18. Edhe për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se ai tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe në pjesën arsyetuese argumentet ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar për to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë tregon se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar dhe se gjykatat e faktit me të drejtë kanë arritur në përfundimin se ai ka kryer veprën penale të vrasjes me paramendim dhe jo vrasjen e kryer në tronditje të fortë psikike të pretenduar prej tij. Po kështu, edhe për sa i përket pretendimit se Gjykata e Lartë ka vepruar si gjykatë fakti, pasi u është referuar fakteve të gabuara, Kolegji vlerëson se ai është haptazi i pabazuar, për sa kohë referimi dhe mbështetja në provat gjyqësore të paraqitura në gjykatat më të ulëta me qëllim interpretimin e ligjit material penal është bërë në mbështetje të arsyetimit të gjykatës së apelit. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e gjyqimit të drejtë të lidhur me standardin e arsyetimit janë haptazi të pabazuara.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.